



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1456/2Prot.

Tiranë, më 18/11/ 2020

V E N D I M

Nr. 170, Datë 18 /11/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.122 regj, datë 26.10.2020, paraqitur nga ankuesi P.L, kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore², në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*llojit të profesionit*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar, ankuesi P.L, ka parashtruar si vijon:

Për 20 vjet unë kam shkrirë dhe derdhur stereotipe (kallëp) forma shtypi prej plumbi + kallaj + antimon. Të tre metalet së bashku përbëjnë forma shtypi (aliazh). Duhet të trajtohesha si fonderist, si shkrirës dhe derdhës metali, por nuk jam trajtuar si i tillë nga ISSh, me pretendimin se kam shkrirë plumb+kallaj+antimon, në sektorin e tipografisë. Shkrirësit e baterive trajtohen që kanë lëndën e parë plumbin. Edhe unë plumb kam shkrirë, me tonelata në ditë dhe nuk përfitoj asnjë gjë. Më kanë thënë 65 vjeç dhe 37 vjet punë, kur me ligjin 526 të vitit 1958 kur unë kam filluar punë, më takonte 15 muaj dhe 25 vjet punë. ISSh thotë se ka ndryshuar ligji.

Kërkoj të trajtohem si shkrirës, derdhje metali fonderi, si ish Uzina Partizani. Çfarë ndryshimi ka shkrirësi i plumbit të baterisë me shkrirësin e plumbit të shtypshkronjës? Për dijeni, vetëm dy

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ISSh.

veta jemi gjallë në këtë profesion dhe me invalid. Gjashtë kolegë kanë vdekur në moshën 51-54 vjeç, pa gëzuar pensionin. Mbetem me shpresë për drejtësi, barazi.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” diskriminimi përkufizohet si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në shqyrtimin paraprak të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi, Komisioneri konstaton se:

Ankuesi P.L, i datëlindjes 01.07.1957, është banor i qytetit të Tiranës. Referuar dokumentacionit të depozituar nga ana e ankuesit dhe konkretisht, Librezës së Punës dhe vërtetimit nr.379 prot., datë 20.01.2017, lëshuar nga ISSh, rezulton se ankuesi ka punuar për periudhën nga viti 1976 - 1996, pranë Kombinatit Poligrafik Tiranë dhe në Shtëpinë Botuese 8 Nëntori, Tiranë. Duke

pretenduar se ka mbushur moshën për të përfituar pension pleqërie, ankuesi ka aplikuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë³, në lidhje me caktimin e pensionit të pleqërisë në kushtet e kategorisë së parë. Me shkresën nr.5352 prot., datë 02.10.2017, DRSSh Tiranë, i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me aplikimin e tij për pension pleqërie, duke e informuar se: *“Duke iu referuar pasqyrës nr.1 të punëve në kategorinë e parë, rezulton se asnjë nga punët e kryera nga ana juaj nuk përfshihet në këtë pasqyrë. Në bazë të nenit 92, të ligjit 7703, datë 11.05.1993 (tabela e moshës dhe punës) sqarojmë se: nga data 01.07.2012 e në vazhdim, kushtet e kategorisë së dytë barazohen me kushtet e kategorisë së tretë. Sa më sipër, ju lind e drejta për pension pleqërie në moshën 65 vjeç dhe vetëm atëherë mund të aplikoni për pension pleqërie.”*

Në vijim, ankuesi i është drejtuar ISSh-së, e cila me shkresën nr.8272/1 prot., datë 17.10.2017, ndër të tjera ka sqaruar ankuesin se: *“..... DRSSh Tiranë, me shkresën nr.5352 prot., datë 02.10.2017, ka refuzuar kërkesën për caktim pensioni, sepse asnjë nga punët e kryera nga ana juaj nuk është në kushtet e kategorisë së parë e përcaktuar me vendimin nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar. Në VKM-në e sipërcituar, Kreu XVIII “Punët në poligrafi”, pika 4, puna e kryer nga ju, derdhje stereotipi, është klasifikuar në punë të kategorisë së dytë. Sa më sipër, e drejta për të përfituar pension pleqërie sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju lind në moshën 65 vjeç”*

Bazuar në faktet dhe kërkimet e parashtruara nga ankuesi, dokumentacionin e depozituar si dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh”, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili parashikon se : *“Ankesa nuk pranohet nëse : paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk pranohet për arsye të mëposhtme:

Në datën 02.10.2017, ankuesi ka marrë përgjigje refuzuese lidhur me kërkesën e paraqitur prej tij, pranë DRSSh Tiranë, për të përfituar pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë, sipas kërkesave të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fakt ky që rezulton i provuar nga shkresa kthim përgjigje me nr.5352 prot., datë 02.10.2017, e DRSSh Tiranë. Sipas përgjigjes së DRSSh, ankuesit i lind e drejta për pension pleqërie në moshën 65 vjeç dhe vetëm atëherë mund të aplikojë për pension pleqërie.

Duke mos qenë dakort me përgjigjen e DRSSh, në datën 09.10.2017, ankuesi ka bërë ankesë pranë ISSh, e cila i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8272/1 prot., datë 17.10.2017. Me shkresën nr.8272/1 prot., datë 17.10.2017, ISSh i ka kthyer përgjigje ankuesit se, atij i lind e drejta për të përfituar pension pleqërie, sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në moshën 65 vjeç, duke konfirmuar përgjigjen që ankuesi kishte marrë edhe nga DRSSh Tiranë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DRSSh Tiranë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Sa më sipër, rezulton se diskriminimi i pretenduar (refuzimi nga DRSSH Tiranë i kërkesës së ankuesit për të përfituar pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë) ka ndodhur në datën 09.10.2017, kur DRSSH Tiranë i ka kthyer përgjigjen refuzuese ankuesit. Rezulton e provuar se ankuesi ka marrë dijeni mbi këtë fakt, pasi në datën 09.10.2017 ai ka paraqitur ankesë pranë ISSh. Duke e konsideruar si diskriminues refuzimin për të përfituar pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë, për punën që ai ka kryer si “derdhës stereotipi”, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, e cila është regjistruar me nr. 122 regj., datë 26.10.2020.

Sa më sipër, rezulton se ankesa pranë Komisionerit është paraqitur më vonë se 3 vite nga marrja dijeni dhe ndodhja e faktit të pretenduar si diskriminues, e për rrjedhojë tej afateve ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, e ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1/a, nenin 33, pika 4, gërma “dh” dhe nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 122 regj., datë 26.10.2020, të paraqitur nga ankuesi P.L, kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Profesioni
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim/Jashtë afateve